

“RETREB PARTNERS” SHPK

AKT THEMELIMI

PER

SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Themeluesit kanë vendosur të krijojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sot më datë 03/11/2025 në bazë të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “PER TREGTARET SHOQERITE TREGTARE”, në bazë të kushteve që vijnë;

Themeluesit:

1. Yzeir Selamaj, atësia Xheladin, lindur në Shushicë, më datë 21.03.1995, dhe banues në adresën Bulevardi “Hatiqet Bendo”, Nd. 17, H. 1, Ap. 5, Vlorë, Shqipëri, me Letërnjoftimin Nr. 038869369, dhe Nr. Personal J50321054L,

NENI I

Yzeir Selamaj do të krijojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, të cilën do ta quajnë: “ReTreb Partners” Sh.p.k., e cila do të ketë si objekt:

Analizë, planifikim, implementim, testim, dokumentim, instalim, zhvillim dhe mirëmbajtje e sistemeve të menaxhimit të informacionit dhe të çdo lloj sistemi tjetër software-ik. Menaxhim dhe drejtim projektsh në fushën e teknologjisë së informacionit, zhvillimit të bizneseve, realizimit të investimeve, kontrollit dhe implementimit të sistemeve arsimore, zhvillimit të platformave të e-learning dhe digital marketing, mentorimit të startupe-ve, implementimit të sistemeve të sigurisë së informacionit, zhvillimit rural, turizmit rural, bujqësisë, agro-përpunimit dhe agroturizmit. Dizenjim software-i, analizë e kërkesave të sistemeve, projektim i arkitekturës dhe i strukturës funksionale të tyre, zhvillim dhe mirëmbajtje e aplikacioneve dhe platformave informatike; programim, integrim i komponenteve, testim, dokumentim teknik, identifikim dhe korrigjim i gabimeve, si dhe modifikime pas vendosjes së software-it në operim. Mirëmbajtje e vazhdueshme e komponenteve dhe ofrim i shërbimeve të suportit për funksionimin e plotë të zgjidhjeve informatike.

Zhvillim dhe dizenjim sistemesh të sigurisë informatike, analizë e kërkesave të sigurisë së klientëve, projektim i arkitekturës së sistemeve, instalime, konfigurime, vendosje në punë, testime sigurie dhe mirëmbajtje përkatëse. Përmirësim dhe përditësim (upgrade) i sistemeve ekzistuese informatike; menaxhim, operim dhe auditim teknik për sistemet software, si dhe ofrim trajnimesh për përdoruesit. Import, eksport, shitje dhe rishitje brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në mënyrë direkte apo indirekte, e produkteve informatike (software dhe hardware), licencave dhe shërbimeve të lidhura me to. Import dhe tregtim printerash, skanerash, fotokopjesh dhe pajisjeve të tjera elektronike bashkë me aksesoret përkatës; ofrim i shërbimeve të mirëmbajtjes për të gjitha këto pajisje.

Hartim, krijim dhe implementim rrjetesh kompjuterike dhe ofrim shërbimesh për mirëmbajtjen e tyre, duke përfshirë pajisjet shoqëruese si kompjutera desktop, laptopë, serverë, routera, switche, sisteme alarmi, sisteme akses kontrolli, sisteme sigurie dhe kamera monitorimi. Ofrim i shërbimeve për krijimin e dhomave të serverëve me të gjithë elementët e nevojshëm sipas standardeve ndërkombëtare. Aplikim dhe implementim projektesh në fusha të ndryshme si teknologjia e informacionit, bujqësia, turizmi, agro-përpunimi, zhvillimi rural, energjia, siguria e informacionit dhe zhvillimi i bizneseve, në bashkëpunim me organizata jofitimprurëse, institucione publike, kompani private, donatorë vendas dhe të huaj, banka të nivelit të dytë, institucione financiare, fonde zhvillimi dhe organizata ndërkombëtare.

Hartim dhe përgatitje të plotë të planeve të biznesit në të gjitha fushat, me të gjithë elementët përbërës për aplikime në institucione kombëtare e ndërkombëtare (shtetërore dhe private), përfshirë dhe institucione kombëtare dhe ndërkombëtare financiare. Hartim dokumentacionesh për aplikime në grante dhe skema mbështetëse kombëtare dhe të huaja për biznese, shoqëri tregtare, fermerë, individë dhe institucione publike apo private. Ofrim shërbimesh informacioni, rekuperimi dhe ristrukturimi kredish, konsulencë profesionale dhe juridike, hartim kontratash, përkthime, marketing dhe trajnime të specializuara për individë dhe biznese.

Realizim studimesh tregu dhe analizash zhvillimi sipas nevojave të klientëve, hartim specifikimesh teknike dhe konsulencë të plotë financiare, ekonomike dhe ligjore. Përfaqësim të palëve të treta në institucione të administratës publike, gjyqësore dhe private. Studim, analizim dhe hartim planesh zhvillimi për zona rurale dhe me interes të veçantë ekonomik, përfshirë zonat e investimeve strategjike. Konsulencë në fushën e të dhënave (Big Data), pjesëmarrje dhe hartim akt-ekspertizash në fusha si teknologjia e informacionit, software, hardware, bujqësi, turizëm, agro-përpunim, zhvillim rural, agroturizëm, energji dhe siguri.

Te kryeje shërbime marketingu dizenjimi, publiciteti, reklamimi për shoqëri dhe ente private ose shtetërore. Gjithashtu Shoqëria për të realizuar objektin dhe qëllimin e saj, mund të ndermarre dhe zhvillojë çdo lloj aktiviteti tjetër të njohur nga legjislacioni shqiptar dhe të ndryshëm nga sa me sipër, tregtar, financiar, promociional apo dorezanes që i vlereson të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimeve të saj. Krijim, menaxhim dhe realizim fushatash marketingu dhe komunikimi, menaxhim e përditësim i llogarive të rrjeteve sociale, publikim dhe shpërndarje materialesh promovuese, dërgim e-mailesh promociionale dhe menaxhim të imazhit të subjekteve në mjedisin dixhital.

Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari tjetër tregtare, industriale, financiare, shërbimi apo investimi, të lejuara nga legjislacioni në fuqi, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin kryesor të saj. Gjithashtu shoqëria mund të ushtroj edhe çdo lloj aktiviteti tjetër të pashprehur më sipër, që lejohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

Shoqëria mund të ushtrojë gjithashtu edhe aktivitete të tjera ndihmëse në përputhje me legjislacionin në fuqi, të konsideruara me përfitim si dhe të dobishme për arritjen e objektivave të saj kryesore. Shoqëria ka të drejtë të bashkëpunojë me persona fizikë, juridikë, me çdo shoqëri tjetër, brenda dhe jashtë vendit.

NENI 2

Shoqëria e ka selinë në Gjirokastrë, Shqipëri në adresën : Lagja Qendër, Rruga "Hysen Dosti", Zona kadastrale 2132, Nr. Pasurie 6/32, Kati I, Këlcyrë, Gjirokastrë.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 3

KOHEZGJATJA Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore pa afat.

NENI 4

KAPITALI THEMELTAR i shoqërisë është 100.00 (njëqind) lekë.

Kapitali i mësipërm është nënshkruar nga “ortakët” e shoqërisë:

- 1- Yzeir Selamaj, zotërues i 1 kuotë, me vlerë nominale 100.00 (njëqind) lekë dhe me vlerë të përgjithshme 100.00 (njëqind) lekë, që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

NENI 5

Administrator i shoqërisë do të jetë:

1. Yzeir Selamaj, atësia Xheladin, lindur në Shushicë, më datë 21.03.1995, dhe banues në adresën Bulevardi “Hatiqet Bendo”, Nd. 17, H. 1, Ap. 5, Vlorë, Shqipëri, me Letërnjoftimin Nr. 038869369, dhe Nr. Personal J50321054L, emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

NENI 6

Shoqëria do të rregullohet përveç këtij Akt Themelimi, edhe me norma të përcaktuara në një Statut, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërisë dhe si i tillë do të fitojë personalitetin juridik me regjistrim në “Qendrën Kombëtare të Bisnesit” në bazë të Ligjit 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Bisnesit” i ndryshuar, ditën kur shoqëria do të legalizohet si person juridik shqiptar.

ORTAKET E SHOQERISE

“RETREB PARTNERS” SHPK

YZEIR SELAMAJ

